

njëpasnjëshme, vëllai i Imerit, Xhemajli, ia arriti më në fund në të njëjtën ditë, nga ora 18:00, të shkonte dhe ta merrte trupin e Imerit. Me ndihmën e bashkëfshatarëve, që u kthyen pas tërheqjes së forcave serbe, Xhemajli e ka varrosur Imerin në varrezat e Vranocit të Vogël/Mali Vranovac. Imeri prehet atje edhe sot.

**Burimi:** deklarata E.U, FDH-18704.

### Bajram (Rrustem) Gogaj

(15.03.1943, shqiptar nga Deçani/Deçane, tregtar, tetë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Bajrami me familje jetonin në **Deçan/Deçane**, në Rrugën *Asim Vokshi*. Në fillim të muajit mars, ai me djemtë Zenunin dhe Brahimin aderuan në UÇK. Kur forcat serbe e sulmuan Deçanin/Deçane më 23.05.1998, Bajrami ka mbetur në qytet. Ka rënë gjatë betejës me forcat serbe që u zhvillua pranë shtëpisë së tij, më **30.05.1998**. Familja kishte dëgjuar se trupi i Bajramit ka mbetur në vendin ku ai u vra. Pas përfundimit të luftës, djali i tij Zenuni i ka gjetur mbetjet mortore të Bajramit, që ishin të mbuluara me dheun e hedhur mbi trupin prapa shtëpisë familjare. Një ditë më vonë, Bajramin e kanë varrosur në varrezat në Deçan/Deçane.

**Burimet:** deklarata R.G, FDH-29222; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

### Brahim (Zymer) Mushkolaj

(27.06.1954, shqiptar nga Deçani/Deçane, katër fëmijë, punëtor, pjesëtar i UÇK-së)

Brahimi ishte i punësuar në fabrikën për pjesë rezervë të veturave në **Deçan/Deçane**. Në datën 20.04.1998, ai aderoi në UÇK. U caktua komandant i një njësi prej 30 ushtarësh, i cili ishte i pozicionuar pranë Fabrikës së Drurit në Deçan/Deçane. Më **30.05.1998**, forcat serbe e sulmuan këtë pozicion të UÇK-së, me ç'rast Brahimin u vra. Trupi i Brahimit ka mbetur në vendin e vrasjes. Mbetjet e tij mortore nuk janë gjetur deri më sot. Në evidencën e të zhdukurve të KNKK-së, rasti i Brahimit është regjistruar me numrin rendor BLG-803252-01.

**Burimet:** J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795.

### Hate (Mehmet Ramaj) Shala

(1.10.1924, shqiptare nga Juniku/Junik, komuna e Deçanit/Deçani, një fëmijë)

Forcat serbe e sulmuan **Junikun/Junik** më 29.05.1998 dhe i detyruan familjet e shumta që të braktisnin fshatin. Për dallim nga bashkëshorti Muharremi, i cili u largua me të rejën dhe nipërit në fshatin Dobrosh/Dobroš, Hatja e moshëthyer ka vendosur të qëndronte me djalin Sadriun, i cili me të afërmit e tij e mbronte fshatin. Ajo e arsyetoi këtë me nevojën që dikush duhej tu përgatiste ushqime mbrojtësve të fshatit. Një ditë më vonë, më **30.05.1998**, diku nga ora 13:00, ajo doli prej shtëpisë për t'i çuar drekën të birit dhe burrave tjerë. Në dalje nga oborri, ajo u qëllua me pushkë snajperi. Ka dhënë shpirt në mbrëmje. I biri e ka varrosur të ëmën në varrezat e Dobroshit/Dobroš. Në muajin korrik apo gusht të vitit 2000, i biri i ka rivarrosur mbetjet mortore të së ëmës dhe të atit [i cili ka pësuar në prill të vitit 1999 dhe u varros në varrezat e Gjakovës/Đakovica] në varrezat e Junikut/Junik.

**Burimet:** deklarata S.Sh, FDH-19253; deklarata Sh.B, FDH-12331; deklarata S.Sh, FDH-31228.

### Isuf (Haxhi) Balaj - Cufë

(1917, shqiptar nga Carrabregu i Epërm/Gornji Crnobreg, komuna e Deçanit/Deçani, bujk, pesë fëmijë)

Kur forcat serbe filluan të sulmonin me predha **Carrabregun e Epërm/Gornji Crnobreg** më 29.05.1998, e gjithë familja Balaj u zhvendos nga fshati përpos Isufit, i cili ka mbetur në shtëpi. Nuk kishte mundësi të lëvizte. Bashkëshortja e kishte parë të gjallë për herë të fundit më **31.05.1998**, kur e vizitoi për një kohë të shkurtër. Pastaj, askush nga familja nuk guxonte të kthehej në fshat. E para që u kthye [në muajin shtator të vitit 1998] ishte bashkëshortja e Isufit. Në shtëpinë e djegur, ajo e ka gjetur trupin e karbonizuar të burrit të vet. Me ndihmën e fqinjëve, ajo